



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Vendim

Nr. 08 datë 21.01.2019

**“Mbi plotësimin e detyrave të Zv/Dekanit për Kërkimit Shkencor”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 93, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në referencë të parimeve bazë të përgjithëshme të Kartës Evropiane të Kërkuesve, dokument i mbështetur nga UT përmes Letrës Zyrtare Mbështetëse, Nr. 773/1 Prot, datë 03.04.2018 (shih për më shumë: [https://euraxess.ec.europa.eu/jobs/charter/declaration-endorsement/show\\_Albania](https://euraxess.ec.europa.eu/jobs/charter/declaration-endorsement/show_Albania)), si dhe në funksion të plotësimit të përshkrimit të pozicionit të punës të Zv/Dekanit për Kërkimin shkencor në kuadër të pilotimit të sistemit të këshillimit për kërkuesit shkencor, Dekanati

Vendosi:

1. Plotësimin e detyrave të Zv/Dekanit për Kërkimin shkencor në funksion të këshillimit të personelit akademik, lidhur me elementë të Karrierës Akademike.
2. Zv/Dekani për Kërkimin shkencor si pjesë e këshillimit për kërkuesit e rinj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja për zgjedh personel akademik të kategorisë “Profesor”, i cili do të shërbejë si Konsulent i Jashtëm.
3. Konsulenti i Jashtëm, ka për detyrë të këshillojë kërkuesit e rinj të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja periodikisht në drejtimet që lidhen me:
  - a) Kualifikimin dhe promovimin individual akademik.
  - b) Botimin e punëve shkencore në revista dhe buletine cilësore kombëtare e ndërkombëtare, me autoritet e faktorë të lartë impakti.
  - c) Organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca, seminare, *Workshop*-e dhe takime me natyrë akademike e universitare, në aktivitete kombëtare dhe sidomos ndërkombëtare.
  - d) Aspekte pedagogjike dhe mësimdhënëse me studentët.
  - e) Kushtet e punës dhe kërkimit shkencor teorik dhe aplikativ.
  - f) Infstrukturën fizike në institucion dhe jashtë tij.
  - g) Përfshirjen në projekte vetjake dhe institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare.
  - h) Konsulenca dhe ndihmesa me karakter administrativ.
  - i) Çdo aspekt tjetër me rëndësi pedagogjike, ligjore, administrative dhe shkencore që kontribuon në përmirësimin e objektivave kualifikuese, kërkuese e publikuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Dekani, Zv/Dekani për Kërkimin Shkencor
5. Periudha e pilotimit shtrihet nga shkurt 2019-shkurt 2020
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DEKAN  
Prof. Dr. Artur Sula

